

Vendim nr. 279 datë 19.11.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Fiona Papajorgji, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Marsida Xhaferllari, anëtarë, në datën 19.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 21 (E) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ELJONA HOXHA, FLAMUR HOXHA, TEUTA HOXHA, BRUNILDA MENE, përfaqësuar nga avokatët Arjan Salati dhe Henrik Ligori, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 331, datë 14.09.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; urdhrit nr. 151 (87-2023-241), datë 27.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; vendimit nr. 00-2023-2120, datë 22.12.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 27, pika 1, 28, pika 5, 36, 41, pika 1, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 77 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*) ka regjistruar procedimin penal nr. 277 të vitit 2020 (*procedimi penal nr. 277/2020*) për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës”, në bashkëpunim, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale, në bashkëpunim” dhe “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë, në bashkëpunim”, të parashikuara nga nenet 245 e 25, 248 e 25, 260 dhe 287, paragrafi 2, shkronjat “a” dhe “b”, të Kodit Penal (KP). Me vendimin e datës 19.09.2022 Prokuroria e Posaçme ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr. 277/2020 në disa procedime penale të tjera, ndër të tjera në procedimin penal nr. 277/1 të vitit 2022 (*procedimi penal nr. 277/1/2022*), në kuadrin e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuar nga neni 248 i KP-së.

2. Mbi bazën e kallëzimit të një gazetari, Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 30, datë 24.02.2023 për veprat penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehjen ose deklarimin e rremë të pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publike ose çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara respektivisht nga nenet 260, 257/a dhe 287 të KP-së. Ky procedim është bashkuar me procedimin penal nr. 277/1/2022 në një procedim të vetëm, për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 260, 257/a dhe 287 të KP-së. Në vijim, Prokuroria e Posaçme i ka atribuar një deputeti, që kishte ushtruar edhe detyrën e zëvendëskryeministrit, cilësinë e personit të dyshuar ndaj të cilit zhvilloheshin hetimet për veprat penale të parashikuara nga nenet 248, 260, 257/a dhe 287 të KP-së.

3. Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 295 akti, datë 16.07.2023, ka lejuar kontrollin personal ndaj disa personave (të afërm me personin e dyshuar) dhe kontrollin e disa vendeve. Konkretisht, është lejuar kontrolli personal i kërkueses Brunilda Mene (motra e personit të dyshuar) dhe i shtetasit E.H. (vëllai i bashkëjetueses së personit të dyshuar, njëkohësisht i biri i kërkueses Flamur Hoxha e Teuta Hoxha dhe bashkëshorti i kërkueses Eljona Hoxha). Ndërsa për sa i takon kontrollit të vendeve, bëhej fjalë për tri banesa të ndodhura në Tiranë dhe në Hamallaj, Durrës, në dy prej të cilave banonte familja e shtetasit E.H. dhe në të tretën banonte familja e kërkueses Brunilda Mene. Sipas pikës 4 të

dispozitivitet të vendimit gjyqësor, kryerja e kontrollit personal dhe e banesës bëhej me qëllim gjetjen dhe sekuestrimin e provave materiale që lidheshin me veprat penale për të cilat kishte filluar procedimi penal.

4. Gjatë ushtrimit të kontrolleve, hetuesit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, kanë sekuestruar disa sende, konkretisht: kërkueses Eljona Hoxha dhe familjarëve të saj (bashkëshortit dhe fëmijëve) i kanë sekuestruar USB (*flash driver*), pajisje IPAD, laptop NEC dhe telefona celularë; kërkuesve Teuta Hoxha dhe Flamur Hoxha i kanë sekuestruar telefonat celularë, ndërsa kërkueses tjetër Brunilda Mene dhe familjarëve të saj (bashkëshortit dhe fëmijës) i kanë sekuestruar laptop të markës Apple, çelës makine Range Rover, çelës makine Mercedes Benz, çelës me mbajtëse çelësi blu me të shkruar “Zyra ISSH”, çelës makine të markës Toyota dhe disa orë. Katër kërkuesit, me pretendimin se sendet e sekuestruara ishin për përdorim vetjak, familjar dhe të përditshëm, si dhe se nuk përbënin prova materiale dhe sende që lidheshin me veprat penale që po hetonte Prokuroria e Posaçme, kanë paraqitur ankim në gjykatë për heqjen e sekuestrës.

5. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, me vendimin nr. 331, datë 14.09.2023, ka vendosur mospranimin e ankimit me arsyetimin se ai ishte i pabazuar në ligj, pasi sekuestroja provuese mund të vendosej mbi çdo send, pavarësisht nga personi titullar i pronësisë ose i përdorimit të tij. Ndonëse kërkuesit kanë paraqitur apel, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*Gjykata e Posaçme e Apelit*) me urdhrin nr. 151 (87-2023-241), datë 27.10.2023, me arsyetimin se ankimi ishte i pabazuar në ligj dhe në prova. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i vënë në lëvizje me rekursin e kërkuesve, me vendimin nr. 00-2023-2120, datë 22.12.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (*KPP*).

6. Në datën 07.08.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Kolegji i Gjykatës, bazuar në nenin 31, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit ka marrë në shqyrtim paraprak ankimin kushtetues individual të kërkuesve brenda afatit ligjor 3-mujor të përcaktuar nga neni 47, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000. Në afatin 3-mujor, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, nuk llogaritet periudha prej 40 ditësh e lejes vjetore e parashikuar nga neni 18, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

II

Pretendimet e kërkuesve

7. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se prej vendimeve gjyqësore të kundërshtuara u janë cenuar:

- 7.1. *Liria personale, dinjiteti vetjak dhe siguria*, të garantuara nga nenet 27, pika 1 dhe 28, pika 5, të Kushtetutës, pasi sekuestrimi i telefonisë celulare të kërkueses Eljona Hoxha është bërë pa kërkuar autorizim nga gjykata, për më tepër që ky veprim u realizua me dhunë, duke i kufizuar lirinë asaj dhe fëmijës së saj në një mjedis privat dhe pa praninë e një personi të besuar ose të një mbrojtësi.
- 7.2. *E drejta për privatësi të korrespondencës*, e garantuar nga neni 36 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë lejuar sekuestrimin e disa pajisjeve elektronike personale, që përmbajnë komunikime personale, të cilat nuk mund të cenohen pa një vendim gjykate. Organi procedues, duke vendosur ekspertimin e të dhënave në përmbajtje të tyre, synon të marrë njoftim për përmbajtjen e korrespondencës pa një vendim autorizues të gjykatës.
- 7.3. *E drejta e pronës*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi objekti i kontrollit dhe sekuestrimit është shumë i përgjithshëm. Vendimi i gjyqtarit të hetimeve paraprake nuk përcakton qartë objektet që lejoheshin të sekuestroheshin, duke u krijuar hetuesve hapësirë të gjerë abuzimi gjatë ekzekutimit të tij. Kontrollit i mungonte objektivi i përcaktuar dhe parashikueshmëria e rezultatit, ndaj ai nuk plotëson kriterin e parashikueshmërisë në ligj. Sekuestrimi është shpërpjesëtimor në raport me qëllimin e ligjshëm që duhet të ndjekë juridiksioni gjyqësor, sepse i ka privuar kërkuesit nga sendet që dukshëm nuk janë prova materiale dhe as sende që lidhen me veprat penale objekt hetimi, por sende personale vetjake. Sendet e sekuestruara vazhdojnë të mbahen prej më shumë se një viti dhe organi i akuzës mund të bënte kopje të materialeve dhe t'ua kthente sendet atyre. Sekuestrimi i sendeve që u përkasin fëmijëve është i paligjshëm, pasi gjykata nuk ka autorizuar kontrollin vetjak të tyre. Në rastin në fjalë, sekuestroja është provuese dhe nuk janë kushtet e një sekuestrimi në bazë të ligjit antimafia, i cili lejon prekjen e pasurisë në pronësi të personave të tretë kur plotësohen kushte të caktuara.
- 7.4. *Të drejtat për ushtrimin e profesionit dhe arsimim*, të garantuara nga nenet 49 dhe 57 të Kushtetutës, pasi kërkuesve u janë sekuestruar pajisje dhe mjete që përdoren për qëllime didaktike dhe profesionale.
- 7.5. *E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit*, e garantuar nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, pasi pretendimet janë rrëzuar në të gjitha

shkallët e gjyqësorit pa arsyetuar thelbin juridik të tyre. Vendimet gjyqësore janë tërësisht stereotipe dhe nuk u japin përgjigje argumenteve themelore të mbrojtjes. Asnjë nga pretendimet e ngritura, të cilat kanë të bëjnë me shkelje kushtetuese dhe ligjore, nuk kanë marrë përgjigje nga vendimet e gjykatave.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkuësve

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë kumulative, në kuptimin që mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

9. Lidhur me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata ka pohuar se sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individë mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimitimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimin nr. 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Mbi bazën e këtij standardi, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se ndaj kërkuësve dhe banesave të tyre është ushtruar kontroll për efekte të një procedimi penal, nëpërmjet të cilit janë sekuestruar disa sende në pronësi të tyre. Ata janë ankuar në gjykatat e zakonshme, duke kërkuar heqjen e masës së sekuestrimit dhe më pas kanë paraqitur ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore, me pretendimin se u janë cenuar disa liri dhe të drejta themelore. Në këtë situatë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkuësit legjitimohen si në aspektin

procedural, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues dhe, po kështu, edhe në aspektin substancial, pasi janë viktima të shkeljeve të të drejtave themelore të pretenduara.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Ky rregull, në thelb, synon t’u japë organeve publike dhe në veçanti gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në çështjen konkrete, kërkuesit kanë kundërshtuar tre vendime gjyqësore, objekti i të cilave lidhet me heqjen e masës së sekuestros dhe kthimin e sendeve të sekuestruara nga Policia Gjyqësore gjatë kontrollit personal dhe të banesave të tyre. Sipas kërkuesve, vendimet e kundërshtuara u kanë cenuar disa të drejta kushtetuese substanciale, ndërkohë që pretendimet me natyrë kushtetuese ata i kanë ngritur edhe në aktet me të cilat kanë vënë në lëvizje gjykatat e zakonshme deri në Gjykatën e Lartë.

13. Mbledhja e Gjyqtarëve, duke mos vënë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të vendimeve objekt i ankimit kushtetues, do të analizojë në vijim kriteret që duhet të plotësojë një vendim i ndërmjetëm në mënyrë që të konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës. Konkretisht, Gjykata ka përcaktuar se vendimi i ndërmjetëm duhet: (i) të ketë kufizuar të drejtën kushtetuese të individit; (ii) të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe të jetë shqyrtuar edhe nga gjykatat më të larta, të cilat të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; (iii) të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pasojat e ardhura në të drejtën kushtetuese të jetë e vështirë ose e pamundur të riparohen gjatë procesit të themelit (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 14, datë 11.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në drejtim të pariparueshmërisë së të drejtave kushtetuese të cenuara, Gjykata analizon edhe kohëzgjatjen e masës (*shih vendimin nr. 74, datë 22.10.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimet që janë objekt i ankimit kushtetues individual, përmes të cilave është kërkuar kthimi i sendeve të sekuestruara, kanë ndërhyrë në disa prej të drejtave themelore të kërkuesve. Ato janë bërë objekt i ankimeve dhe gjykatat e zakonshme kanë mbajtur qëndrim për to. Po kështu, në kushtet kur kërkuesit janë persona të tretë në procedimin penal është e vështirë që pasojat e ndërhyrjes në të

drejtat kushtetuese të tyre të riparohen gjatë procesit të themelit, që do të vendosë për faktin penal dhe (pa)fajësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Për këto arsye, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se vendimet e kundërshtuara konsiderohen përfundimtare në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës dhe se kërkuesit e kanë përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.¹

15. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata ka pohuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, momenti i konstatimit të cenimit të së drejtës përkon me datën e marrjes dijeni efektivisht të vendimit, e cila është data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë mban datën 22.12.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 07.08.2024. Kërkuesit kanë paraqitur shkresën nr. 3326/1 prot., datë 01.07.2024, me të cilën Gjykata e Lartë i ka kthyer përgjigje përfaqësuesit ligjor të tyre se vendimi i saj është bërë i disponueshëm në datën 26.04.2024. Duke iu referuar kësaj date, si momenti i konstatimit të cenimit të të drejtave themelore, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit 4-mujor, rrjedhimisht ata legjitimohen edhe *ratione temporis*.

17. Në drejtim të legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar se vendimet gjyqësore për mospranimin e kërkesës për heqjen e sekuestros dhe kthimin e sendeve u kanë cenuar lirinë personale, dinjitetin vetjak dhe sigurinë, të drejtat për privatësi të korrespondencës, të pronës, për ushtrimin e profesionit dhe arsimim, si dhe për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsytimit.

18. Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se në rastin përjashtimor të kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm, Gjykata i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar, ndaj, në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së

¹ Gjyqtarët Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për mosplotësimin e këtij kriteri legjitimiteti nga kërkuesit dhe moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare për këtë shkak, me arsyetimin se vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare dhe nuk mund t'i nënshtrohen gjykimit kushtetues, qëndrim ky i mbajtur dhe i elaboruar në mendimet paralele të vendimit nr. 18, datë 13.03.2024 të Gjykatës, si dhe në vendime të tjera të kësaj natyre në vijim.

drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 74, datë 22.10.2024; nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Për sa i takon pretendimit për cenimin e së drejtës për privatësi të korrespondencës, kërkuesit kanë parashtruar se gjykatat kanë lejuar sekuestrimin e disa pajisjeve elektronike personale që përmbanin komunikime personale, të cilat nuk mund të cenohen pa një vendim gjykatë. Sipas tyre, organi procedues, duke vendosur ekspertimin e të dhënave në përmbajtje të tyre, ka synuar të marrë informacion për përmbajtjen e korrespondencës pa një vendim autorizues të gjykatës.

20. Gjykata ka pohuar se liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose të çdo mjeti tjetër të komunikimit, e sanksionuar në nenin 36 të Kushtetutës, përbën një nga të drejtat themelore autonome dhe që mund të mbrohet veçmas gjyqësisht. Ajo e ka vlerësuar atë nën konceptin e mbrojtjes së të drejtës së jetës private, duke theksuar se jeta private përbën hapësirën e mbrojtur, brenda së cilës individi zhvillon personalitetin e tij dhe marrëdhëniet me individët e tjerë (*shih vendimin nr. 30, datë 05.07.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Nga ana tjetër, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) e ka trajtuar të drejtën për respektimin e korrespondencës të realizuar nëpërmjet teknologjisë, brenda objektit të nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*), në veçanti të dhënat nga një telefon celular/laptop dhe/ose kopje e imazhit të ekranit të tij, mesazhet elektronike (*e-mail*) dhe të dhënat e ruajtura në serverët kompjuterikë, përfshirë *hard drives* dhe *floppy disks* (*shih Saber kundër Norvegjisë, 17.12.2020, § 48; Iliya Stefanov kundër Bullgarisë, 22.05.2008, § 42; Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar, 03.04.2007, § 41; Petri Sallinen dhe të tjerët kundër Finlandës, 27.12.2005, § 71*). Neni 8 i *KEDNJ*-së mbron konfidencialitetin e “komunikimeve private”, pavarësisht nga përmbajtja e korrespondencës në fjalë dhe çfarëdo forme që mund të marrë. Ajo që mbron neni 8 i *KEDNJ*-së është konfidencialiteti i të gjitha shkëmbimeve në të cilat individët mund të angazhohen për qëllime komunikimi (*shih Michaud kundër Francës, 06.12.2012, § 90; Frérot kundër Francës, 12.06.2007, §§ 53, 54*). Ndërhyrjen në respektimin e korrespondencës si një të drejtë të garantuar nga neni 8 i *KEDNJ*-së, *GJEDNJ*-ja e ka vlerësuar bazuar në kriteret e paragrafit të dytë të këtij neni, pra nëse “*ndërhyrja është e parashikuar me ligj*”, dhe se “*a është e nevojshme në një shoqëri demokratike për të arritur një qëllim legjitim*”.

22. Nën dritën e sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se kërkuesit nuk kanë parashtruar ndonjë argument ose fakt konkret mbi të dhënat e tyre që gjendeshin në sendet e sekuestruara, në kuptimin nëse bëhej fjalë për të dhëna dokumentare ose për komunikime. Në këtë drejtim,

Mbledhja e Gjyqtarëve thekson se kur pretendohet shkelja e të drejtave kushtetuese përgjatë procedimit penal, ankuesi duhet të deklarojë faktet në mënyrë specifike, të saktë dhe të plotë, në mënyrë që të krijohet mundësia e vlerësimit nëse ekziston ose jo një gabim procedural me pasoja kushtetuese. Për këtë arsye, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimi i kërkuesve se sekuestrimi i sendeve elektronike rrezikon të nxjerrë ose publikojë të dhëna të jetës private të tyre, është haptazi i pabazuar. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në ankimin kushtetues individual nuk është parashtruar asnjë e dhënë që të krijojë ndonjë dyshim se gjatë hetimit dhe gjyqimit të çështjes mund të keqpërdoren të dhënat dhe komunikimet e jetës private të kërkuesve, në kushtet kur legjislacioni procedural penal ofron garancitë e duhura në këtë drejtim. Për rrjedhojë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimi i kërkuesve për cenimin e së drejtës për privatësi të korrespondencës, është haptazi i pabazuar dhe nuk mund të merret në shqyrtim. Në këtë pikë, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se sekuestrimi i sendeve në përdorim të kërkuesve, përfshirë edhe ato teknologjike, është kryer në zbatim të vendimeve gjyqësore, për efekte të procedimit penal për qëllime të provës dhe sipas rregullave ligjore procedurale penale. Gjykatat e zakonshme i kanë konsideruar sendet e sekuestruara me vlerë provuese për faktet e procedimit penal dhe të dhënat në to, të llojit dokument. Kjo do të thotë se ka një parashikim ligjor që lejon ndërhyrjen eventuale në komunikimet dhe korrespondencën elektronike të kërkuesve dhe është e nevojshme për të arritur qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal.

23. Për sa i takon pretendimit për cenimin e *së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe arsimin*, kërkuesit kanë argumentuar se atyre u janë sekuestruar sende të tilla, si: USB, pajisje IPAD, laptop dhe çelësa zyre, të cilat përdoren për qëllime të ushtrimit të profesionit dhe për qëllime didaktike. Në analizë të këtij argumenti, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ndonëse është e vërtetë që këto mjete mund të përdoren ose përmbajnë informacione dhe të dhëna për qëllime profesionale dhe arsimore, ato nuk janë të vetmet që mund të sigurojnë ushtrimin e këtyre të drejtave, por dukshëm ekziston mundësia e mjeteve alternative. Për rrjedhojë, argumentet e kërkuesve nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur ndonjë dyshim në këtë drejtim, ndaj pretendimi për cenimin e këtyre të drejtave është haptazi i pabazuar, dhe, si i tillë, nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Lidhur me pretendimin për cenimin e *lirisë personale, sigurisë dhe dinjitetit njerëzor*, të garantuar nga neni 27 i Kushtetutës, në ankimin kushtetues individual është parashtruar se sekuestrimi i telefonisë celulare të kërkueses Eljona Hoxha është bërë pa kërkuar autorizim nga gjykata, për më tepër që ky veprim është realizuar me dhunë, brenda mjedisit të një zyre private dhe pa praninë e një personi të besuar ose të një mbrojtësi.

25. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në ankimin kushtetues individual nuk është parashtruar saktësisht se sa ka zgjatur në kohë veprimtaria e sekuestrimit të sendit, ndaj pretendimi se për kryerjen e këtij veprimi procedural kërkueses Eljona Hoxha i është hequr liria personale është haptazi i pabazuar. Po kështu, Mbledhja e Gjyqtarëve konstaton se gjykatat e zakonshme këtij pretendimi i janë përgjigjur se sekuestrimi, në rrethanat e zbatuara, ka qenë i ligjshëm dhe i arsyeshëm. Konkretisht, sipas tyre, përgjatë procedimit penal, bazuar në nenet 300-302 të KPP-së, në kushtet e verifikimeve të ngutshme në vend dhe kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet të ndryshojnë ose të humbasin është Policia Gjyqësore që sekuestron provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale, madje edhe pa një urdhër të veçantë, por që gjithsesi pasqyrohet në procesverbalin e sekuestrimit përkatës, arsye për të cilën procesverbali brenda 48 orëve duhet të paraqitet te prokurori, i cili po ashtu, brenda 48 orëve të ardhshme, nëse ekzistojnë kushtet, vleftëson sekuestron, në të kundërt kthen sendet e sekuestruara. Po kështu, sipas gjykatave të zakonshme, në çdo rast mbrojtësi ka të drejtë të jetë i pranishëm, por meqenëse sekuestro provuesë është veprimtari befasuesë, në verifikime të ngutshme në vend, ndihma e mbrojtësit nuk shtrihet në lajmërimin e tij që më parë për ekzekutimin e saj (*shih faqet 4 – 5 të urdhrit të Gjykatës së Posaçme të Apelit*). Ndërsa Gjykata e Lartë është shprehur se nuk rezulton mosrespektimi ose zbatimi i gabuar i ligjit material ose procedural në rastin në shqyrtim, duke e lënë të pacenueshëm vendimmarrjen e gjykatave të faktit (*shih paragrafin 20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Në analizë të argumenteve të gjykatave për trajtimin e këtij shkak, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se arsyetimi i tyre është i arsyeshëm dhe nuk krijon dyshime për cenimin e lirisë personale, dinjitetit njerëzor dhe sigurisë.

26. Për sa i takon pretendimit *për cenimin e së drejtës së pronës*, kërkuesit kanë argumentuar se objekti i kontrollit është shumë i përgjithshëm dhe vendimi i gjyqtarit të hetimeve paraprake nuk përcakton qartë objektet që lejoheshin të sekuestroheshin, duke u krijuar hetuesve hapësirë të gjerë abuzimi gjatë ekzekutimit të tij. Sipas kërkuesve, kontrollit i mungon objektivi i përcaktuar dhe parashikueshmëria e rezultatit, ndaj ai nuk plotëson kriterin e parashikueshmërisë në ligj. Po kështu, sipas tyre, sekuestrimi është shpërpjesëtimor në raport me qëllimin e ligjshëm që duhet të ndjekë juridiksioni gjyqësor, sepse i ka privuar kërkuesit nga sendet që dukshëm nuk janë prova materiale dhe as sende që lidhen me veprat penale objekt hetimi, por sende personale vetjake. Sendet e sekuestruara vazhdojnë të mbahen prej më shumë se një viti dhe organi i akuzës mund të bënte kopje të materialeve dhe t'ua kthente ato atyre. Në rastin në fjalë, shprehen kërkuesit, sekuestroja është provuesë dhe nuk janë kushtet e një sekuestrimi në bazë të ligjit antimafia, i cili lejon prekjen e pasurisë në pronësi të personave të tretë kur plotësohen kushte të caktuara.

27. Lidhur me të drejtën e pronës, Gjykata ka theksuar se kjo e drejtë përfshin çdo posedim të sendeve ose të të drejtave të tjera materiale pasurore dhe në një shtet demokratik individit duhet t'i garantohet gëzimi i qetë dhe pa pengesa të paarsyeshme ose joproporcionale i kësaj të drejte. Në çdo rast, kjo e drejtë shtrihet ndaj sendeve, pronësia e të cilave është fituar në përputhje me ligjin. Edhe sipas nenit 41 të Kushtetutës e drejta e pronës mund të kufizohet, duke përcaktuar si kriter garantues të këtij kufizimi interesin publik (*shih vendimet nr. 18, datë 19.03.2024; nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 36, datë 21.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për sa më lart, bazuar dhe në thelbin e argumenteve të kërkuësve, Mbledhja e Gjyqtarëve do të vlerësojë nëse gjykatat kanë dhënë mjaftueshëm argumente për ligjshmërinë e kontrollit dhe sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe nëse veprimet e kryera kanë respektuar garancitë kushtetuese të domosdoshme që gjejnë zbatim në procedurat e kontrollit dhe sekuestrimit.

29. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se në banesat e shtetasve E.H., L.M. dhe kërkuëseve Eljona Hoxha dhe Brunilda Mene është ushtruar kontroll nga oficerët e Policisë Gjyqësore, gjatë të cilave, ndër të tjera, në cilësinë e provës materiale, janë sekuestruar: telefona celularë, USB, pajisje IPAD, laptop, telefona celularë, çelësa të tre makinave, çelësa zyre dhe disa orë. Kontrolli i kryer dhe sekuestrimi i sendeve të luajtshme dëshmohep nëpërmjet akteve procedurale – procesverbali për kontrollin e vendeve dhe dy procesverbale për sekuestrimin e sendeve, që mbajnë datën 18.07.2023. Me vendimet e datës 19.07.2023, të Prokurorisë së Posaçme, është disponuar vleftësimi i sekuestros për aparatet telefonike që u përkasin dy prej kërkuësve Teuta Hoxha dhe Flamur Hoxha. Gjithashtu, me vendim të Prokurorisë së Posaçme “Për sekuestrimin e sendeve/dokumentave”, të datës 21.07.2023, është vendosur sekuestrimi i një aparati telefonik i kërkuëses Eljona Hoxha, me arsyetimin se *përgjatë hetimeve ka rezultuar se me prokurën e posaçme, datë 11.03.2023, personi nën hetim ka autorizuar kërkuësen në fjalë, duke i dhënë tagra të kryejë një sërë veprimesh mes të cilave edhe transaksione të ndryshme bankare dhe ekziston dyshimi se kërkuësja po bën përpjekje me qëllim transferimin e parave të ndodhura në llogaritë bankare të personit nën hetim në destinacione të ndryshme, ndaj lind e domosdoshme të sekuestrohet aparati telefonik i kërkuëses, pasi vlerësohet se në të mund të gjenden të dhëna me rëndësi për hetimin*. Ndërsa, me procesverbalin e datës 21.07.2023 është dokumentuar ekzekutimi i vendimit të sekuestros të aparatit telefonik të kërkuëses Eljona Hoxha.

30. Kërkuësit kanë kërkuar heqjen e sekuestros për sendet e sekuestruara, pasi, sipas tyre, ato nuk gëzojnë cilësinë e provës materiale. Kërkesa e tyre është kundërshtuar nga Prokuroria e Posaçme, e cila gjatë shqyrtimit gjyqësor ka pretenduar se të gjitha pajisjet i janë nënshtruar aktit të ekspertimit. Sipas prokurorisë, në momentin që do të përfundojë akti i ekspertimit, të gjitha

pajisjet do t'i kthehen atyre që u janë sekuestruar, ndërsa për pjesën tjetër të provave, siç janë çelësat dhe ora, duke mbajtur parasysh që personi nën hetim është duke u hetuar edhe për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe normalisht shtrirja e hetimit shkon edhe te familjarët, ajo duhet të bëjë verifikimet përkatëse në lidhje me burimin e pasurive të personit nën hetim dhe të familjarëve të tij.

31. Në vijim, gjykatat e faktit nuk i kanë pranuar kërkesat e kërkuësve, bazuar në argumentin se, *së pari*, sendet e sekuestruara që janë objekt gjykimi mbahen nga ana e prokurorisë për qëllim prove; *së dyti*, sekuestrimi i bërë nga Policia Gjyqësore është në zbatim të vendimit të gjykatës dhe vendimit të prokurorisë për sekuestrimin e provës materiale; *së treti*, sendet objekt ankimi janë të domosdoshme për të provuar faktet për të cilin ka nisur procedimi penal nr. 277/1/2022 dhe se nuk ka rëndësi nëse provat materiale janë në pronësi të personit që hetohet ose të personave të tjerë. Sipas gjykatave, me prokurën e posaçme të datës 11.03.2023 nga personi nën hetim është autorizuar një prej kërkuësve të kryejë transaksione në llogaritë e tij bankare, veprime këto që kanë lidhje me pasojat e veprave penale, për të cilat dyshohet të jenë kryer prej tij, ndaj është e arsyeshme të dyshohet se në komunikimet e kërkuësës me personin nën hetim mund të gjenden të dhëna ose prova që vërtetojnë fakte për këto vepra penale. Një nga mjetet e mundshme të komunikimit është edhe aparati celular, në *"flash memory"*-n e të cilit janë shënuar këto komunikime. Ky send me cilësinë e dokumentit provues lidhet me veprat penale, për të cilat hetohet personi nën hetim, prandaj mbi bazën e këtij arsyetimi është i ligjshëm dhe i arsyeshëm vendimi i prokurorisë që ka vendosur sekuestrimin e aparatit të telefonit celular që i përket kërkuësës Eljona Hoxha. Për të njëjtin shkak është i arsyeshëm dhe i ligjshëm sekuestrimi i sendeve të tjera, me dyshimin se në pajisjet në *"flash memory"*-t e tyre mund të kenë komunikime që shërbejnë për vërtetimin e fakteve. Për sa i takon kthimit të sendeve të sekuestruara, gjykatat kanë argumentuar se me rënien e shkakut të sekuestrimit të provës materiale, pra me rënien ose përmbushjen e nevojave të të provuarit, ato do të çlirohen nga situata e sekuestruar, situatë që mund të ndodhë si përgjatë fazës së hetimit paraprak, ashtu edhe në proces. Në përgjigje të vendimit përfundimtar të themelit, sipas gjykatave të faktit, disponohet veçanërisht edhe se sendet që kanë shërbyer ose ishin caktuar si mjet për kryerjen e veprës penale dhe sendet që përbëjnë përfitimin e nxjerrë nga ajo ose shpërblimin e dhënë, ose të premtuar për kryerjen e saj, për shkak të ligjit kalojnë në favor të shtetit, pra konfiskohen.

32. Ndërsa Gjykata e Lartë nuk e ka pranuar rekursin, me argumentin se gjykata e apelit ka dhënë mjaftueshëm arsye në ligjshmërinë e sekuestrimit të këtyre pajisjeve, në përdorim të kërkuësve që ndajnë të njëjtin mjedis, për sa kohë që ka arsye të bazuara se mund të përmbajnë të

dhëna që i shërbejnë hetimit të çështjes. Sipas Gjykatës së Lartë, gjykatat kanë vlerësuar se ka arsye të bazuara për të konkluduar se telefonat e sekuestruar nga kërkuesit, si pajisje të afta të mbajnë të dhëna (në formë elektronike), mund të përmbajnë të dhëna të cilat mund t'i shërbejnë hetimit, ku prokuroria do të vlerësojë nëse ato i shërbejnë hetimit dhe duke e mbajtur pajisjen për aq kohë sa mund të nevojitet për marrjen e të dhënave. Sipas saj, prokuroria nuk mund të përjashtojë *apriori* pajisje të gjetura në mjediset ku u krye sekuestrimi, të cilat mund të mos jenë përdorur nga kërkuesit dhe që nuk përmbajnë të dhëna që i shërbejnë hetimit. Ndaj, sipas Gjykatës së Lartë, për shkak të llojit të veprave penale për të cilat dyshohet personin nën hetim, rezulton i bazuar edhe sekuestrimi i sendeve të tjera, mbi të cilat ose mbi bazën e të cilave prokuroria do të kryejë hetimet/verifikimet përkatëse, në funksion të procedimit penal. Gjithashtu, sipas saj, ndryshe nga sa arsyetohet mbrojtja në rekurs, vendimi i gjykatës së apelit nuk rezulton i paarsyetuar, përkundrazi, të dhënat mbi të cilat është bazuar arsyetimi i asaj gjykate burojnë nga ajo vendimmarrje, duke përmbushur kriterin e përcaktuar në pikën 3 të nenit 112 të KPP-së. Kurse pretendimet që lidhen me mënyrën e kryerjes së sekuestrimit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se dalin jashtë objektit të kësaj çështjeje dhe se mund të adresohen me mjete të tjera, të parashikuara në ligjin procedural penal (*shih paragrafët 14 – 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

33. Në analizë të sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se vendimmarrja e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është mbështetur në parashikimet e ligjit procedural penal, sipas të cilave sekuestroja si masë preventive e marrë gjatë procesit penal, pavarësisht se cili është organi procedues që disponon në vendosjen e saj, në varësi të situatës ligjore dhe fazës së gjykimit, kufizon të drejtën e disponimit të pasurisë së mbajtësit të saj. Për të garantuar këtë të drejtë nga veprimet abuzive të organit procedues, ligjshmëria e të gjitha veprimeve kontrollohet nga gjykata, sikurse ka ndodhur edhe në rastin konkret. Në këtë kuptim, përgjatë hetimit paraprak, sekuestrimi provues kërkohet nga prokurori dhe miratohet nga gjyqtari, ndërkohë që gjatë kontrollit mund të sekuestrohen sende që ndonëse nuk përfshihen në vendimin përkatës, lidhen me njëjtën vepër penale që po hetohet (*neni 207 i KPP-së*). Sekuestrimi ekzekutohet nga Policia Gjyqësore që sekuestron provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale, veprimet e së cilës dëshmohen në procesverbalet përkatëse, sikurse ka ndodhur edhe në rastin në shqyrtim. Konkretisht, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, rezultojnë tre procesverbale për kontrollin e vendeve dhe sekuestrimin e sendeve që mbajnë datën 18.07.2023, nëpërmjet të cilave është pasqyruar kontrolli i banesave që i përkisnin E.H. dhe L.M., të ndodhura në Tiranë, gjatë të cilave janë gjetur prova materiale dhe sende që sipas shënimeve janë sende personale, dokumentet e familjes, materiale të punës dhe të blera ndër vite. Po kështu, me tre vendime që i përkasin datave

19.07.2023 dhe 21.07.2023, dy prokurorët e çështjes kanë disponuar vendime për sekuestrimin e sendeve dhe vleftësimin e sekuestros lidhur me aparatet telefonike të tre kërkuesve Eljona Hoxha, Teuta Hoxha dhe Flamur Hoxha, mbështetur në arsyetimin se në to mund të gjenden të dhëna të rëndësishme për hetimin. Për sekuestrimin e aparatit telefonik të kërkueses Eljona Hoxha, është argumentuar se ajo është autorizuar nga personi nën hetim për të kryer transaksione bankare në emër të tij, ndaj ekziston dyshimi për transferimin e parave në destinacione të ndryshme. Dy vendimet për vleftësimin e sekuestros që mbajnë datën 19.07.2023 i janë njoftuar nga Prokuroria e Posaçme kërkuesit Flamur Hoxha me shkresën e datës 28.07.2023.

34. Për sa më lart, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se në rastin konkret, kufizimi i disponimit të lirë të sendeve të sekuestruara ka ndjekur një qëllim të ligjshëm dhe për to është ndjekur rregullisht procedura ligjore. Nga ana tjetër, prokuroria dhe gjykatat kanë dhënë argumente të mjaftueshme dhe bindëse se për se janë sekuestruar sendet, një pjesë e të cilave pas përfundimit të aktit të ekspertimit do t'u kthehen pronarëve të tyre, ndërsa për pjesën tjetër do t'u verifikohet burimi i krijimit, në kushtet kur vepra penale objekt hetimi është ajo e pastrimit të produkteve të veprës penale.

35. Parë nën këtë optikë, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se pretendimet e kërkuesve janë haptazi të pabazuara, ndaj dhe kërkesa nuk mund të kalojë për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.